



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**  
**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

04.03.2021

Zbatimi në praktikë i legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë

**TEZA 4**

**ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)**

**1. Tatimpaguesi në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen:**

- a. Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët
- b. të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit
- c. të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit
- d. të ardhurat bruto nga interesa bankarë
- e. a+b
- f. a+b+c
- g. a+b+c+d
- h. Asnjë prej alternativave

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

**2. Kush është norma e kontributeve të sigurimeve shoqërore?**

- a. 9.5% e pagës bruto paguhet nga punëdhënësi dhe 15% nga punëmarrësi;
- b. 9.5% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 15% nga punëdhënësi;
- c. 15% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 15% nga punëdhënësi;
- d. 9.5% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 9,5% nga punëdhënësi;
- e. 1,7% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 1,7% nga punëdhënësi;
- f. 24.5% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 0% nga punëdhënësi;
- g. 0% e pagës bruto paguhet nga punëmarrësi dhe 24.5% nga punëdhënësi;

**Përgjigja e saktë është alternativa B**

### **3. Përrjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale:**

- a. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.
- b. Bursat e nxënësve dhe të studentëve
- c. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqesish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi
- d. të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, resident
- e. të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente
- f. a+b+c
- g. Të gjitha alternativat

**Përgjigja e saktë është alternativa F**

### **4. Organizatat Jo-fitimprurëse regjistrohen dhe marrin NIPT-in:**

- a. Në QKB
- b. Në Dhomën e Tregtisë
- c. Në Administratën Tatimore
- d. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve
- e. Në njësi të pavarur brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- f. Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve
- g. Në njësi të pavarur brenda Këshillit të Ministrave
- h. Asnjëra më sipër

**Përgjigja e saktë është alternativa C**

### **5. Klasifikohen si shpenzime të panjohura:**

- a. Kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe të truallit
- b. vlera e shpërblimeve cash
- c. interesat e paguara, të cilat nuk tejkalojnë normën mesatare të interesit 12 mujor të kredisë për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë
- d. gjobat, kamatë-vonesat dhe kushtet e tjera penale
- e. a+d
- f. c+d
- g. a+b+c
- h. Asnjë prej alternativave

**Përgjigja e saktë është alternativa E**

### **6. Aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së 6% në transaksionet:**

- a. shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësisimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit
- b. dhënia dhe negocimi i kredive, si edhe menaxhimi i kredive nga ana e kredidhënësit

- c. furnizimi i shërbimeve të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, të mësimdhënies shkollore apo universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit
- d. furnizimi i shërbimeve të mësimdhënies shkollore apo universitare, të kryera privatisht nga mësuesit;
- e. furnizimi i librave të cdo lloji
- f. të gjitha alternativat me sipër
- g. a dhe e
- h. c dhe d

**Përgjigja e saktë është alternativa E**

**7. Cilat nga kriteret e mëposhtem duhet të plotësojë Aplikuesi, për t'iu dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar sipas Kodit Doganor**

- a. të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor;
- b. të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;
- c. të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të veprimeve të tij dhe të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontrolleve të duhura doganore;
- d. të ketë aftësi paguese që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë
- e. a dhe b
- f. c dhe d
- g. a, b dhe c
- h. të gjithë alternativat e mësipërme janë të nevojshme por jo shteruese

**Përgjigja e saktë është alternativa H**

**8. Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë zbatohet për:**

- a. Tatimpaguesit, administratën tatimore, agjentët tatimorë, agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjerë, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor;
- b. Personat e ngarkuar për të paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- c. Personat që paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa u përket pagesës dhe mbledhjes së kontributeve;
- d. Sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
- e. Të gjitha më sipër;
- f. Asnjëra më sipër;
- g. Alternativa a; b dhe c.
- h. Alternativa a; dhe c.

**Përgjigja e saktë është alternativa E**

**9. Cilat nga datat e mëposhtme korrespondojnë me datat e parapagimit të kësteve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël?**

- a. 31 mars, 31 qershor, 31 shtator, 31 dhjetor
- b. 31 janar, 31 mars, 31 qershor, 31 shtator
- c. 20 mars, 20 qershor, 20 shtator, 20 dhjetor
- d. 1 korrik, 1 dhjetor
- e. 31 mars, 31 dhjetor
- f. 31 qershor, 31 shtator
- g. 20 prill, 20 korrik, 20 tetor, 20 dhjetor
- h. Asnjera

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

**10. Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm:**

- a. organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- b. persona të tjerë juridikë, të cilët nuk regjistrohen në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe përfaqësi e ambasada të huaja, entet publike kombëtare apo vendore, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm me to;
- c. përfaqësuesit tatimorë të tatimpaguesve jorezidentë;
- d. të vetëpunësuarit në veprimtari, si shitës ambulant, sipas përkufizimit ligji.
- e. kryefamiljari, që punëson individë, si punëtorë shtëpie, kujdestarë dhe persona të tjerë tëkësaj natyre;
- f. fermeri.
- g. Të gjitha më sipër
- h. Asnjë më sipër

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

## **PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

1. Përcaktoni radhën e pagesave të kontributeve dhe detyrimeve tatimore.

### **Zgjidhje:**

Bazuar në neni 79 të Ligjit Nr.9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore është si më poshtë:

Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara. Pagesat e kontributeve të sigurimeve dhe të detyrimeve tatimore bëhen sipas kësaj radhe:

- a) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore;
- b) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
- c) kontributet e detyrueshme suplementare të sigurimeve shoqërore;
- ç) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
- d) tatimet;
- dh) kamatëvonesat,
- e) gjobat;
- ë) kostot administrative.

2. Kush janë kategoritë që mbrohen nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm?

### **Zgjidhje:**

a) Personat e punësuar në lidhje me: - paaftësinë e përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes; - barrëlindjen; - pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes; - aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale; - papunësinë.

b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me:

- barrëlindjen;
- pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

3. Si trajtohet shërbimi i furnizimit të tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme? A janë ato objekt i TVSH-së?

### **Zgjidhje:**

a) Ligji përcakton si furnizime të përjashtuara nga TVSH:

i) furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese si dhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa, përveç furnizimit të procesit të ndërtimit;

ii) furnizimin i tokës

Me “ndërtesë” kuptohet çdo lloj strukture e fiksuar në tokë;

Me “tokë” kuptohet çdo zonë e papunuar, e papërpunuar, e pazhvilluar dhe e pandërtuar e tokës.

Në kuptim të dispozitës së mësipërme nuk përbën dallim përsa i përket përjashtimit nga TVSH nëse kemi të bëjmë me ndërtesa për banim apo për qëllime të tjera.

b) Gjithashtu është furnizim i përjashtuar nga TVSH dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

i. dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj;

ii. strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;

iii. dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;

iv. dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;

v. dhënien me qira të kasafortave.

4. Cilat konsiderohen si të ardhura të tatueshme për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale.

### **Zgjidhje:**

a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës;

Përjashtohen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranura nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventa apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim; (0.5 pike)

b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqëri tregtare; (0.5 pike)

c) të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emëtuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji; (0.5 pike)

ç) të ardhurat që rrjedhin nga drejta e autorit dhe pronësia intelektuale; (0.5 pike)

d) të ardhurat nga enfi-teoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjisllacionit tregtar; (0.5 pike)

dh) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme; (0.5 pike)

e) të ardhurat e individëve nga lojërat e fati dhe kazinotë. (0.25 pike)

f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndermjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksoiner zotëron dhe ja shet një personi tjetër; (0.25 pike)

g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë. (0.25 pike)

h) të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave." (0.25 pike)

5. Kur aplikohet zbritja e pjesshme e TVSH-së dhe si llogaritet përqindja e fillestare dhe përfundimtare e zbritjes së TVSH-së.

### **Zgjidhje:**

Nëse furnizimet e mallrave dhe shërbimeve përdoren nga një person i tatueshëm, si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë, atëherë vetëm pjesa e TVSH-së që lidhet me kategorinë e parë të transaksioneve është e zbritshme.

Pjesa e TVSH-së së zbritshme përcaktohet për tërësinë e transaksioneve të kryera nga ana e personit të tatueshëm.

Llogaritja e koeficientit (përqindjes) së zbritjes së TVSH-së.

Koeficienti i zbritjes së TVSH- së llogaritet nga raporti i mëposhtëm:

a) në numërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet që sjellin të drejtën e zbritjes.

b) në emërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH- në, lidhur me transaksionet e përfshira në numërues dhe me transaksionet që nuk sjellin të drejtën e zbritjes.

Për llogaritjen e koeficientit të zbritjes së TVSH- së, nuk merren parasysh shumat e mëposhtme:

a) vlera e qarkullimit të realizuar nga furnizimet e mallrave kapitale, të përdorura nga personi i tatueshëm për nevoja të biznesit të tij;

b) vlera e qarkullimit, të realizuar nga transaksione financiare dhe të pasurive të paluajtshme nëse këto transaksione janë rastësore;

c) vlera e qarkullimit, të realizuar nga shërbime financiare, nëse këto transaksione janë rastësore.

Koeficienti i zbritjes së TVSH- së përcaktohet mbi bazë vjetore, përcaktohet në përqindje dhe rumbullakoset në maksimum me njësinë më të lartë.

Koeficienti i zbritjes së TVSH- së, e aplikueshme provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm. Në mungesë të

këtyre transaksioneve ose kur shuma e tyre është e papërfillshme, koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së vlerësohet provizorisht prej vetë personit të tatueshëm, në bazë të parashikimeve të tij dhe nën mbikëqyrjen e administratës tatimore.

Zbritja e TVSH- së, e kryer mbi bazën e koeficientit fillestar të zbritjes, duhet të rregullohet në periudhën e parë tatimore të vitit pasardhës, sipas koeficientit përfundimtar të zbritjes së TVSH- së. Personi i tatueshëm duhet të njoftojë administratën tatimore për koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH- së që do të aplikojë gjatë vitit dhe për mënyrën e llogaritjes së saj, jo më vonë se:

a) data 31 janar, në rastin kur nuk është viti i parë i aplikimit të koeficientit të zbritjes së TVSH- së. Në këtë rast koeficienti fillestar i zbritjes së TVSH-së është koeficienti përfundimtar i zbritjes së TVSH- së për vitin paraardhës;

b) afati i deklarimit të periudhës së parë tatimore, në të cilën lind detyrimi për të aplikuar koeficientin fillestar të zbritjes së TVSH-së.

6. Cila është baza kryesore për vlerësimin e vlerës doganore të mallrave. Cilat janë rastet kur metoda përsosore nuk mund të përdoret, dhe jepni një shëmbull të një metode dytësore.

### **Zgjidhje:**

Baza kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet, kur është e nevojshme. (2 pike)

Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet në bazë të metodës baze, ajo përcaktohet duke ndjekur, sipas radhës një nga metodat dytësore. (1 pike)

Metoda dytësore parashikon se vlera doganore përlllogaritet si me poshtë: (1 pike për një nga alternativat e mëposhtme)

a) vlera e transaksionit e mallrave identike, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

b) vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

c) vlera e bazuar në çmimin për njësi, me të cilën mallrat e importuara ose mallrat identike apo të ngjashme, që u korrespondojnë mallrave të importuara, u janë shitur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në sasinë më të madhe të përgjithshme, personave, të cilët nuk kanë lidhje me shitësit;

ç) vlera e përlllogaritur e cila konsiston në shumën e:

i) koston ose vlerën së materialeve dhe prodhimit ose të përpunimeve të tjera, të përfshira në prodhimin e mallrave të importuara;

ii) një shumë, që përfaqëson fitimet dhe shpenzimet e përgjithshme, të barabartë me atë që sjellin zakonisht shitjet e mallrave të së njëjtës cilësi ose të të njëjtit lloj me mallrat për t'u vlerësuar, të prodhuara nga prodhues të vendit eksportues e me destinacion Republikën e Shqipërisë;

iii) koston ose vlerën të elementeve të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 67.



7. Shpjegoni rastet kur lejohet të bëhet një saktësim i TVSH-së së faturuar prej furnizuesit të mallit/shërbimit, në rast anulimi apo tërheqje prej furnizimit ose të reduktim të çmimit pas momentit të kryerjes së furnizimit.

**Zgjidhje:**

a) Për qëllime të kryerjes së saktësimit furnizuesi do të lëshojë një faturë prej faturave që përdor, e cila është faturë korigjuese dhe sipas rastit dhe qëllimit për të cilin është aplikuar duhet të përmbajë shënimin:

- Faturë korigjuese, kur nuk kërkohet që midis palëve të rimburohen vlerat (pagesa nuk është kryer në rast tërheqje prej furnizimit).

- Faturë korigjuese - Notë krediti nëse korigjon në ulje vlerën e faturës fillestare;

- Faturë korigjuese- Notë debiti nëse korigjon në rritje vlerën e faturës fillestare;

Notë krediti ose notë debiti lëshohet në ato raste kur prej blerësit pretendohet kthimi (rimbursimi) i shumës nga furnizuesi.

b) Me anulim apo tërheqje prej furnizimit kuptohet:

- një furnizim do të konsiderohet i anuluar, në datën kur, pasi është bërë porosia dhe kryer parapagimi, blerësi, i cili nuk do ta vazhdojë këtë porosi, i kërkon shitësit t'i kthejë (rimburojë) shumën e parapagimeve të bëra;

- furnizim do të konsiderohet i tërhequr, në datën kur palët rivendosen në situatën që ishin para realizimit të furnizimit. Pra mallrat i kthehen shitësit pasi furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi ose mallrat janë të dëmtuara ose shërbimi nuk është kryer.

8. Shpjegoni se kur konsiderohet një person resident në Republikën e Shqipërisë:

**Zgjidhje:**

1) Individidi, në rast se:

- ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil (0.5 pike)

- është shtetas shqiptar dhe funksionar konsullor, diplomatik ose i ngjashëm i Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj. (0.5 pike)

2) Individidi, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore. (1 pike)

3) Personi juridik, i cili:

a) ka seline qendrore (zyren qendrore) ne Republikën e Shqipërisë; (0.5 pike)

b) ka vendin e menaxhimit efektiv te biznesit ne Republikën e Shqipërisë. (0.5 pike)

4. Personi fizik, që, sipas legjislacionit tregtar, është regjistruar me këtë cilesi në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve. (1 pikë)

9. Cilat janë kushtet që duhen plotësuar në mënyrë që “Borxhi i keq” të njihet si shpenzim i zbritshëm?

### **Zgjidhje:**

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, borxhi i keq njihet si shpenzim i zbritshëm, në rast se plotësohen, njëkohësisht, tri kushtet e mëposhtme:

- a) Një shumë, që korrespondon me këtë borxh, është përfshirë më parë në të ardhurat;
- b) borxhi është fshirë nga librat kontabël të tatimpaguesit;
- c) janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e tij (3 pikë)

Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, fshirja e borxhit të keq, lidhur me procesin e kredidhënies, njihet si shpenzim i zbritshëm me plotësimin e këtyre afateve:

a) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesi, në rast se kredia është e siguar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme;

b) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme.

c) në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet para afateve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” më lart, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen si të tilla. (1 pikë)

10. Kur kalon në regjistrin pasiv një tatimpagues? A paraqet deklarata tatimore tatim paguesi për periudhën e qëndrimit pasiv?

### **Zgjidhje:**

1. Administrata tatimore transferon regjistrimin e tatimpaguesit nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore, në rast se përmbushet, të paktën, një nga kushtet e mëposhtme:
  - nuk ushtron më veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm; (1 pikë)
  - nuk dorëzon deklaratën tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm; (1 pikë).
  - deklaron në QKB pezullim veprimtarie tregtare dhe paguan të gjitha detyrimet tatimore. (1 pikë).
2. Për periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv, tatimpaguesi nuk paraqet deklarata periodike tatimore dhe ndaj tij nuk llogariten gjopa për mosdeklarim tatimor. (1 pikë).

## **USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)**

### **Ushtrimi 1**

Shoqëria juaj ka qënë në proces kontrolli nga Drejtoria Rajonale Tatimore-Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Në përfundim të kontrollit tatimor, shoqërisë i kanë rezultuar detyrime shtesë, mbi të cilën janë aplikuar gjobat përkatëse. Ju dëshironi të ndiqni të gjitha procedurat e ankimimit në përputhje me Ligjin për Procedurat Tatimore.

**Kërkohët: Jepni një përshkrim të procedurave për tu ndjekur nga shoqëri në fjalë. Ju lutem konsideroni që raportit i marrë, është ai paraprak dhe faza finale do të jetë ankimimi në Gjykatë.**

### **Zgjidhje:**

Në përgjigjen e tij, kandidati duhet të ketë përfshirë sa më poshtë:

Faza 1: Ankimimi i Raportit paraprak pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore

15 ditë nga marrja e raportit paraprak dërgohet ankimi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore. Brënda 5 ditësh nga marrja e ankimimit, Drejtoria Rajonale lëshon Raporti Kontrollin Final së bashku me Njoftim Vlerësimin.

Faza 2: Ankimimi pranë Drejtorisë Apelimit Tatimor/Komisionit të Apelimit Tatimor

Brënda 30 ditësh nga marrja e raportit kontrollit final, tatimpaguesi dërgon ankimimin e tij pranë Drejtorisë Apelimit Tatimor/Komisionit të Apelimit Tatimor.

Si kusht për ankimim, tatimpaguesi duhet të ketë paguar apo vendosur garanci detyrimet shtesë të vendosura nga grupi i kontrollit tatimor, me perjashtim të gjobave dhe kamavonesave.

Faza 3. Ankimimi në Gjykatë Administrative

Në rast të mos pranimit të rezultatit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor/Komisionit të Apelimit Tatimor, tatimpaguesi deponon akt-padi në Gjykatë. Akt-padia dërgohet brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit nga orari në fjalë.

Në të gjitha rastet, si datë e marrjes së njoftimeve nga organet përkatëse konsiderohet data e kuponit postar.

### **Ushtrimi 2**

Individi X gjatë muajit prill 2019, ka patur të ardhura bruto nga burimet si më poshtë:

- Të ardhura bruto nga punësimi në subjektin Z 200,000 Lekë dhe honorar nga pjesëmarrja në bord në këtë subjekt 40.000 lekë.
- Të ardhura nga pjesëmarrja në komisionin e vlerësimit të ofertave pranë Ministrisë 20,000 Lekë
- Të ardhura bruto nga dividenti i subjektit rezident në RSH në shumën 300.000 lekë.
- Arkëtim nga shoqëria e sigurimit për dëmtimin e automjetit 100.000 lekë.

- Të ardhura nga shitja e aksioneve të një shoqërie rezidente ne RSH ku ishte pjesëmarrës 5.000,000 Lekë.  
Vlera e blerjes së aksioneve është 2,000,000 Lekë
- Të ardhura të përftuara nga punëdhënësi për rast sëmundje 30,000 Lekë.

### **Kërkohet:**

**Për secilën prej të ardhurave individuale më sipër, përcaktoni nëse janë të tatueshme, bazën e tyre të tatueshme dhe shumën e tatimit të llogaritur për këto të ardhura.**

**Tregoni mënyrën e deklarimit dhe pagesës së tatimit.**

### **Zgjidhje:**

Të ardhurat bruto tek shoqëria Z do të përfshijnë dhe honorarin nga bordi dhe do të jenë 240,000 lekë. Këto të ardhura do të taten në mënyrë progresive me tatimin mbi të ardhurat nga punësimi. Llogaritjet si më poshtë:

30.000 lekë\*0% 0 Lekë

120,000 lekë x 13% 15,600 lekë

90,000 lekë x 23% 20,700 lekë

**Totali 36,300 Lekë (2 pike)**

- Të ardhura nga pjesëmarrja në komisionin e vleresimit të ofertave pranë Ministrisë 20,000 Lekë, do të taten me 15% tatim në burim. (20,000 lekë \*15%=3,000 lekë). Deklarimin dhe pagesën e kryen shoqëria brenda datës 20, të muajit pasardhës. **(1 pike)**

- Të ardhura bruto nga dividendi i subjektit rezident në RSH në shumën 300.000 lekë, do të taten me 8% tatim në burim. (300,000 lekë \* 8%=24,000lekë) Deklarimin dhe pagesën e kryen shoqëria brenda dates 20, të muajit pasardhës. **(1 pike)**

- Arkëtim nga shoqëria e sigurimit për dëmtimin e automjetit 100.000 lekë, është e ardhur e patatueshme. **(0.5pike)**

- Të ardhura nga shitja e aksioneve të një shoqërie rezidente ne RSH ku ishte pjesëmarrës 5.000,000 Lekë. Vlera e blerjes së aksioneve është 2,000,000 Lekë.

Tatimi në burim për tu paguar (5 milion-2 milion) \*15%=450,000 lekë. Deklarimin dhe pagesën e kryen individi, nëpërmjet deklaratës mujore të tatimit në burim ose deklaratës vjetore. - Të ardhura të përftuara nga punëdhënësi për rast sëmundje 30,000 Lekë, është ardhur e patatueshme pasi është brenda limitit vjetor të 20% të pagës vjetore. **(0.5 pike)**

### **Ushtrimi 3**

Taulanti është i punësuar pranë subjektit Beta me pagë mujore prej ALL 250,000. Gjithashtu, ai është i punësuar edhe pranë subjektit Alpha me page ALL 70,000.

**Kërkohet: Llogarisni kontributet që paguan Taulanti në secilin subjekt, dhe gjithashtu kontributet që paguan secili subjekt për Taulantin.**

### **Zgjidhje:**

Në subjektin Beta, normat e sigurimeve shoqërore paguhen mbi pagën maksimale prej 132,312 në nivelin 15% prej punëdhënësit dhe 9.5% prej punëmarrësit. Ndërkohë sigurimet shëndetësore paguhen mbi pagën e plotë bruto prej ALL 250,000 në nivelin 1.7% si për punëdhënësin si për punëmarrësin.

Në subjektin Alpha, Taulanti dhe subjekti paguajnë sigurimet shëndetësore mbi pagën bruto prej ALL 70,000. Duke qënë se Taulanti ka paguar në subjektin Beta sigurimet shëndetësore mbi pagën maksimale, ai nuk paguan më detyrime.

### **Ushtrimi 4**

Një person juridik, rezident në Shqipëri, për vitin 2018, ka aktivitet në Shqipëri, si edhe një degë në Itali, ku realizon fitim neto si më poshtë:

- nga aktiviteti në Shqipëri: 30.000.000 lekë;
- nga aktiviteti në Itali: 16.000.000 lekë.

Tarifa e tatimit në Shqipëri 15%

Tarifa e tatimit në Itali 36%

### **Kërkohet:**

**a) Llogarisni Tatimin mbi fitimin që duhet te paguaj personi juridik?**

**b) Tatimpaguesi sjell dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Llogarisni Tatim Fitimin?**

### **Zgjidhje:**

Në bazë të dispozitave të këtij ligji (neni 17) ky person, meqenëse është rezident shqiptar, i nënshtrohet tatimit në Shqipëri mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pra detyrimi tatimor në Shqipëri do të jetë:

- fitimi në total: 46.000.000 lekë
- tatim fitimi =  $46.000.000 \times 15\% = 6.900.000$  lekë **(2 pike)**

Por, për fitimin që ka realizuar në Itali tatimpaguesi është tatuar atje (si jorezident) me tarifën e tatimit fitimit në Itali që është 36%. Pra, tatimi i paguar në Itali:

$16.000.000 \times 36\% = 5.760.000$  lekë **(1 pike)**

Tatimpaguesi sjell dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Pas kësaj, organi tatimor shqiptar bën reduktimin e tatimit si më poshtë:

- tatimi që duhej të paguhej sikur të ardhurat e realizuara në Itali të realizoheshin në Shqipëri:  $16.000.000 \times 15\% = 2.400.000$  lekë. Pikërisht për këtë shumë do të bëhet reduktimi i tatimit, pra:

6.900.000 -2.400.000 = 4.500.000 lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të paguajë në Shqipëri (2 pike)

### **Ushtrimi 5**

Shoqëria “A”, subjekti i tatueshëm për TVSH-në në Shqipëri, në muajin Prill të vitit 2020, për arsye të aktivitetit të saj me humbje, i shet kompanisë “B” një ndërtesë (magazinë) me një vlerë pa tvsh 500.000.000 lekë. Kompania “B” është ka aktivitetet të përjashtuar nga TVSH.

Për ndërtesën (magazinë) të shoqërisë “A” kemi këto informacione shtesë.

- Ndërtesa është ndërtuar dhe financuar nga vetë shoqëria A për nevojat e saj të aktivitetit.
- Ndërtimi ka filluar me 3 Janar 2013 dhe ka përfunduar në 30 Shtator 2016.
- Vlera e ndërtesës është njohur me koston e ndërtimit sipas situacioneve mujore. Vlera përfundimtare sipas situacioneve me marrjen në dorëzim të punimeve është 450,000,000 lekë pa tvsh.
- Shërbimet e punimeve janë në vlerën 90.000.000 lekë pa TVSH dhe janë kryer nga shoqëria.
- Nga 3 Janar 2013 deri në 30 Shtator 2016 shoqëria “A” ka kredituar TVSH-në e materialeve dhe të shpenzimeve të tjerë dhe në total vlera e tatueshme është 360,000,000 lekë dhe TVSH e kredituar 72,000,000 lekë. Në total, respektivisht sipas viteve është kredituar TVSH-ja:
  - në vitin 2013 ka kredituar 15,000,000 lekë
  - në vitin 2014 ka kredituar 20,000,000 lekë
  - në vitin 2015 ka kredituar 30,000,000 lekë
  - në vitin 2016 ka kredituar 7,000,000 lekë

### **Kërkohet:**

**Sa është shuma e TVSH-së që duhet t’i kthehet Drejtorisë së Tatimeve, nëpërmjet metodës së korigjimit të librit të blerjes së muajt Prill 2020?**

### **Zgjidhje:**

Në Ligjin dhe Udhëzimin për TVSH-në është përcaktuar që për aktivet kapitale të paluajshme siç është rasti i ndërtesës, të përfituara deri 31 Dhjetor 2014 afati i korigjimit është 5 vjeçar dhe pas datë 1 Janar 2015 afati i korigjimit është 10 vjeçar (me koficientet perkatës (1/5;1/10).

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një ndërtim në ekonomi, ku ndërtuesi dhe financuesi janë njëjti person. Për sa më sipër aktiviteti i ndërtimit është zhvilluar në disa periudha tatimore. Viti i parë në të cilin shoqëria “A” ka kredituar TVSH-në për materialet e blera për procesin e ndërtimit është viti 2013. Duke marrë vitin 2020 si vit kalendarik të plotë, në bazë të Ligjit për TVSH-në duhet të kryhen korigjim e TVSH-së si më poshtë:

a) Për vitin 2013,

Periudha: 2020-2013 = 7 vite

TVSH e këtij viti nuk do të korigjohet pasi periudha është mbi 5 vjet

b) Për vitin 2014

Periudha: 2020-2014 = 6 vite

TVSH e këtij viti nuk do të korigjohet pasi periudha është mbi 5 vjet

c) Për vitin 2015

Periudha 2020-2015 = 5 vite

Koficienti:  $(10-5)/10 = 5/10$

TVSH e këtij viti duhet do të korrigojohet me:  $30,000,000 \text{ lekë} * 5/10 = 15,000,000 \text{ lekë}$

d) Për vitin 2016

Periudha (2020-2016) = 4 vite

Koficienti  $(10-4)/10 = 6/10$

TVSH e këtij viti duhet do të korrigojohet me:  $7,000,000 \text{ lekë} * 6/10 = 4,200,000 \text{ lekë}$

Shuma totale e TVSH-së është që duhet korrigjuar në ulje është 19,200,000 lekë.

TVSH-ja e korrigjuar në ulje do t'i kthehet Drejtorisë së Tatimeve dhe do të njihet si kosto shtesë e vlerës kontabël të ndërtesës. Kostoja totale e ndërtesës do të shkojë në vlerën 469,200,000 lekë.

### **Ushtrimi 6**

Personi i tatueshëm kryen veprimtari ekonomike si konsulente tregtar, si dhe organizon kurse profesionale të licencuara nga Ministria e Arsimit, dhe në vitet 2019 dhe 2020 ka këto tregueslidhur me furnizimet e kryera.

Viti	Furnizime te tatueshme me tvsh	Furnizime te perjashtuara	Qarkullimi total	Koeficienti i zbritjes
2019	3.000.000	2.000.000	5.000.000	60%
2020	2.500.000	2.000.000	4.500.000	56%

Personi i tatueshëm në korrik 2020 merr nga një person i tatueshëm furnizime shërbimi punime rikonstruksionin të zyrave ku kryen veprimtarinë e tij ekonomike, në vlerën 1.500.000 lekë, TVSH e paguar 300.000 lekë. Gjithashtu në muajin korrik 2020 ka kryer edhe shpenzime të përgjithshme administrimi me vlerë 500.000 lekë, TVSH e paguar 100.000 lekë.

**Kërkohet: Sa TVSH do të zbresë personi i tatueshëm për periudhën tatimore korrik 2020, dhe rregullimi vjetor në zbritjen e TVSH-së në periudhën janar 2021?**

### **Zgjidhje:**

Në vitin 2019 në periudhën e parë në të cilën personi i tatueshëm kryen edhe furnizime të përjashtuara përveç atyre të tatueshme aplikon një koeficient fillestar të zbritjes me vlerësimin e tij të përafërt. P.sh 40%. Në janar 2020 llogarit koeficientin përfundimtar mbi treguesit faktik të realizuar dhe bën rregullimin me koeficientin 60% për TVSH-në e blerjeve të realizuara në 2019 nëse ndryshimi i TVSH-së së zbritshme është mbi 20.000 Lekë.

Nëse që në momentin që fillon veprimtarinë personi i tatueshëm ka dijeni që do ti kryejë të dy veprimtaritë atëherë koeficientin mund ta aplikojë që në fillim pa pritur periudhën e parë kur kryen edhe transaksione të tatueshme.

Ndërkohë në periudhën tatimore korrik 2020, personi i tatueshëm do të zbresë TVSH-së sipas koeficientit fillestar të zbritjes (koeficienti faktik i vitit 2019) pra:

TVSH e zbritur provizorisht=  $(300.000\text{lekë}+100.000\text{ lekë}) \times 60\% = 240.000\text{ lekë}$ .

Në janar 2021 personi i tatueshëm llogarit zbritjen e TVSH-së sipas koeficientit përfundimtar të

Zbritjes.

TVSH e zbritshme faktikisht =  $(300.000\text{ lekë}+100.000\text{ lekë}) \times 56\% = 224.000\text{ lekë}$ .

Në periudhën tatimore janar 2021 personi i tatueshëm do të bëjë rregullimin si më poshtë:  
Zbritja e

TVSH sipas Koeficientit përfundimtar të TVSH	224.000 lekë;
(-) zbritja e TVSH sipas Koeficientit fillestar të TVSH	240.000 lekë;
(=) Rregullimi i Zbritjes së TVSH	-16.000 lekë.

Meqëse ndryshimi i TVSH-së së zbritshme është më pak se 20.000 Lekë, nuk kryhen veprimet për rregullimin e zbritjes së TVSH-së.

## **Ushtrimi 7**

“Shoqëria A” - shoqëri jorezidente detyrohet të paguajë TVSH në Shqipëri në bazë të dispozitave ligjore përkatëse. Për të përmbushur këtë detyrim ligjor, emëron si përfaqësues tatimor një tatimpagues shqiptar, i cili është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me emërtimin “Shoqëria B” dhe numër identifikimi të personit L00000000X. Juve jeni përfaqësues ligjor i Shoqërisë B.

**Kërkohet: Çfarë procedurash do ndiqni si përfaqësues tatimor i sapoemëruar nga “Shoqëria A”?**

### **Zgjidhje:**

- Jo më vonë se 5 ditë pas emërimit si përfaqësues tatimor nga “kompania A” do të paraqitem në drejtorinë rajonale tatimore në të cilën “kompania B” është e regjistruar, për të aplikuar për regjistrimin e përfaqësuesit tatimor (2 pikë).
- dhe pajisjen e tij me një numër identifikimi të personit të tatueshëm për TVSH-në me emërtimin: “kompania B” për “kompaninë A”, me statusin “përfaqësues tatimor” (1 pikë).
- Brenda 5 ditëve pasi të jetë caktuar, përfaqësuesi tatimor duhet të dorëzojë aplikimin për regjistrim në drejtorinë e shërbimit dhe të regjistrimit të tatimpaguesit në drejtorinë rajonale tatimore, ku “kompania B” është e regjistruar si tatimpagues (2 pikë).



## **Ushtrimi 8**

Marriot Shpk ka 50 dhoma hoteli, dhe eshte nje hotel me 5 yje ne Durres. Gjatë muajit janar 2021 janë përdorur 40 nga dhomat e hotelit cdo dite të muajit. Gjatë muajit shkurt 2021 janë përdorur 75% të dhomave për 10 ditëshin e parë të muajit, dhe nuk janë përdorur asnjë nga dhomat për pjesën e mbetur të muajit.

Për kategorinë e Bashkisë Tiranë për hotele me 4 dhe 5 yje taksa është 350 lekë.

### **Kërkohet:**

**Përllogarisni taksën vendore të fjetjes për muajin Janar dhe Shkurt 2021 për Marriot**

### **Zgjidhje:**

**Janar 2021:**

40 dhoma hoteli\*31 dite muaji\*350 leke per dhome per dite = 434,000 leke (2 pikë)

**Shkurt 2021:**

0.75 perqindja e dhomave \*50 dhoma = 37.5 dhoma, pra do te rumbullakoset ne 38 dhoma, ose ne 37 dhoma. (1 pike per sqarimin qe nuk mund te paguhet per gjysem dhome)

(2 pikë për secilën nga përgjigjet e mëposhtme)

38\* 10 dite \* 350 leke per dhome per dite = 133,000 lekë

37\*10 dite \* 250 leke per dhome per dite = 129,500 lekë

## **Ushtrimi 9**

Bashkia e Qytetit B ka marrë një financim nga një donator i huaj për projektin e rikonstruksionit të një shkolle publike. Vlera e preventivit të hartuar është 30.000.000 lekë dhe TVSH 20% 6.000.000 lekë. Donatori i huaj nuk pranon të financojë vlerën e TVSH-së (6.000.000 lekë). Pra vlera e financimit që merr Bashkia nga donatori i huaj për këtë rikonstruksion shkolle është 30.000.000 leke.

Shoqëria ndërtuese “D” (tatimpagues TVSH-je) e kontraktuar nga Bashkia kryen rikonstruksionin e shkollës për një periudhë 3 mujore dhe lëshon çdo muaj faturë tatimore për Bashkinë (me vlerë pa TVSH 10.000.000 lekë), bazuar në situacionin e punimeve që është në përputhje të plotë me preventivin.

### **Kërkohet:**

**a) A duhet të llogarisë TVSH në shitje shoqëria ndërtuese “D” çdo muaj dhe a duhet ta paguajë këtë TVSH?**

**b) Duke qenë se donatori i huaj nuk e paguan TVSH-në, kush duhet ta parashikojë dhe përballojë TVSH prej 6.000.000 lekë?**

### **Zgjidhje:**

- a) Shoqëria Ndërtuese D duhet të llogarisë TVSH për çdo faturë të bazuar në situacionin mujor të punimeve. Pra fatura që do të lëshohet çdo muaj për Bashkinë B është  $10.000.000 + 2.000.000$  (TVSH) = 12.000.000 lekë;
- b) TVSH prej 6.000.000 duhet të përballohet nga Bashkia B si kosto lokale për zbatimin e këtij projekti.

### **Ushtrimi 10**

Një tatim pages merr me postë rekomande më dt. 20 Shkurt 2021 një njoftim vlerësimi për gjobë për mospagimin e kësteve të tatim-fitimit për periudhën tetor-dhjetor 2020. Data e njoftim vlerësimit është 15 Janar 2021.

**A është në afat tatimpaguesi për ta ankimuar këtë gjobë? Arsyetoni përgjigjen tuaj.**

#### **Zgjidhje:**

Referuar LIGJ Nr. 9920, datë 19.5.2008, njoftim vlerësimet dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik ose të postës rekomande. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Në situatën tonë data e marrjes konsiderohet dt. 20 Shkurt 2021 dhe duke u nisur nga kjo datë tatimpaguesi është brenda afatit 30 ditor për ankimim të gjobës.